



# DANIEL AGOLLI

***“Midis pasionit dhe llogarisë,  
Këshillimi i Karrierës ndezi  
dritën brenda meje”***

Danieli është djali tipik i brezit të sotëm, ai fansi i thekur i teknologjisë, djali modern, nga ato mendjet e mençura që kanë kuriozitet për të përftuar çdo informacion që atij i duket kurioz apo i vlefshëm për pasionet e tij.

*“Njohja ime e parë me Këshillimin në karrierë ishte në Njësinë e Zhvillimit në ambientet e shkollës, pasi Shkolla Teknike Ekonomike në Tiranë ka të integruar këshillimin në karrierë”* tregon Danieli. Ai është 20 vjeç, sot student.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS  
ALBANIA



PARTNERËT SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Danieli tregon se, kur erdhi koha që i duhej të vendoste për të zgjedhur për arsimin e lartë, ai nuk po dinte të vlerësonte me kujdes se çfarë objektivash kishte për karrierën në të ardhmen e tij.

*"U konsultova tek zyrat e Këshillimit të Karrierës. Me anë të orientimit nga stafi, vendosa të ndjek informatikën ekonomike në Universitetin Metropolitan, gjë të cilën në fillim e kisha me ndrojtje. Mendoja se nuk kisha informacion të plotë rreth konkurrencës, mundësive të punësimit apo përshtatjes me këtë degë. Por, falë sistemeve digjitale dhe stafit të këshilluesve të karrierës, arrita të marr përgjigjet për të bërë një zgjedhje të sigurtë".*



### **Si arriti Danieli të kuptojë se kishte nevojë për ndihmën e Këshilluesit të Karrierës?**

Ai tregon se, kur kuptoi që po përfundonte rrugëtimi i tij në arsimin e mesëm, si çdo i ri në pozicionin e tij, u ballafaqua me shumë opsione për arsimin e lartë.

*"Duke dashur të mos bëj zgjedhjen e gabuar, u konsultova me sa më shumë persona të ndryshëm me përvojë, të cilët kishin opinione aq ndryshe nga njëri-tjetri, sa ndjeva nevojën të kisha më mirë një orientim profesional".*

Gjatë kësaj periudhe kërkimi, fatmirësisht shkolla i bëri me dije se mund të vizitonte Zyrën e Këshillimit të Karrierës, pjesë e strukturës së shkollës.

*"Unë e vizitova Zyrën e Këshillimit që në vitin e 3-të, duke marrë parasysh që arsimi profesional ka 4 vite, ky ishte një avantazh për t'u përgatitur drejt zgjedhjes së universitetit".*

Çdo universitet ofron një shumëllojshmëri drejtimesh, të cilat kanë specializimet e tyre. Danieli tregon konfuzionin që ndjeu, që me "një fjalë është pak për ta përshkruar". Ai e tregon këtë ndjesi të përzier me shumë pikëpyetje që mplekseshin herë me dëshira çasti, herë me pasione, e herë me llogari siç ishte:

*"kisha studiuar 4 vite ekonomi, s'mund t'i hidhja poshtë".*

Nëpërmjet këshillimit për karrierë, ai u bind se zgjedhja e tij do të përqendrohej së pari tek 4 vitet e studimit ekonomik.

*"Për mua arsimi i lartë ka qenë gjithmonë i rëndësishëm, sepse industria e punës për momentin të kërkon të kualifikuar gjithmonë me arsimin të lartë. Por, gjithmonë kam menduar, se përfitimi i një aftësie të re është gjithmonë një bonus i madh motivimi për çdokënd".*

Ai kujton sot, se kur u paraqit në Zyrën e Këshillimit të Karrierës, pati një bisedë shumë konstruktive, se si iu desh të plotësonte një seri testesh dhe opsionesh në një sistem, i cili me anë të Inteligjencës Artificiale gjeneronte profesione apo drejtime ideale në bazë të kualifikimeve dhe personalitetit.

*"Pasi dhashë të dhënat, procedura ishte e tillë që në monitorin e kompjuterit dilte në formë sugjerimi profesioni që më përafrohej mua. Në momentin kur e pashë të shkruar profesionin që duhej të zgjidhja, si një nga opsionet që unë kisha prirje, një dritë sikur u ndez brenda meje dhe mendova: 'pse jo, pse jo unë'".*

Pas seancave të këshillimit, Danieli u ndje i lehtësuar që dilemat e tij morën fund.

*"Jam i tërhequr pas informatikës por nuk e zgjedha, sepse kuptova që tashmë kisha krijuar një bagazh dijeshe në ekonomi. Biznesi dhe sipërmarrja janë pasion i imi dhe është e pamundur të jesh i suksesshëm në botën e biznesit, nëse nuk je i informuar mbi tregun dhe ekonominë. Ndaj, ndihma e profesionistëve më orientoj bindshëm, se duhej të isha studenti që jam sot".*

Danieli e përfundon historinë e tij të dilemave, "duke marrë parasysh pasionin që kisha që i vogël për teknologjinë, një degë që do i kombinonte të dyja, ishte Teknikë Ekonomike, dhe kjo ishte zgjedhja thjesht ideale".

Ai është falënderues ndaj Zyrës së Këshillimit për Karrierën, pasi përvoja e orientimit në tregun e punës ishte mëse e nevojshme dhe shumë e rëndësishme për të dhe për shumë të rinj të tjerë që e frekuentojnë.